

STATUTI DHE AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“JUS LEGITIMUM & PARTNERS” SH.P.K

Mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil,, Ligjin nr. 991 date 14.08.2008 “Per Shoqerite tregtare” I ndryshuar, Ligji nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin tone te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi dhe statuti te shoqerise;

KREU I

THEMELIMI, EMRI, ZOTERIMI, OBJEKTI I VERIMTARISE, SELIA

Neni 1

Ortaket themelues

Sot me date 25.02.2022 Ortaket Themelues te shoqerise:

1. Z. Edvin Kepi i biri i Fadil-it i datelindjes 16.02.1978 ne Tirane dhe banues ne adresen: Andon Zako Cajupi Nr. 5 Apartamenti 5 Tirane, dhe mbajtes dokumentit te identifikimit Pasaporte me nr. H80216134W.
2. Z. Oliget Kume i biri i Petrike-s i datelindjes 15.01.1979 ne Elbasan dhe banues ne adresen: Lagja Visarion Xhuvani, Rruga; Vasil Taja Elbasan dhe mbajtes i Kartes se identitetit nr. H90115008U.

Hartojme kete Akt Themelimi dhe Statut te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “JUS LEGITIMUM&PARTNERS” SH.P.K mbeshtetur ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”(i ndryshuar), Ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” i ndryshuar, dhe cdo dispozite tjeter te zbatueshme te legjislacionit shqiptar si me poshte:

Neni 2

Forma Ligjore e Shoqerise

Shoqeria “JUS LEGITIMUM&PARTNERS” SH.P.K eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (“me poshte referuar Shoqeria”).



Shoqeria "JUS LEGITIMUM&PARTNERS" SH.P.K eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga "ortakete e shoqerise", te cilet pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Ortaket gezojne kuoten e tyre ne shoqeri, ne perpjestim me kontributin qe kane dhene ne kapital.

Neni 3

Kohezgjatja e Veprimtarise

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete me afat te pacaktuar dhe fillon me regjistrimin e shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 4

Selia/ Adresa e Regjistruar

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla nr. 1 Kati i pare, Nr. 6 Tirane.

Administratori mund te krijojte NIPT-e sekondare te Shoqerise.

Neni 5

Objekti i Veprimtarise

- Konsulence ligjore per personat juridike dhe fizike.
- Konsulence Ligjore ne fushen civile, penale, te drejten tregtare dhe nderkombetare tregtare, administrative, familjare dhe marredhenieve juridike te punes, Rregullat e Prokurimit publik etj.
- Perfaqesime ligjore ne organet administrative dhe sistemin gjygesor te Republikes se Shqiperise per klientet e interesuar.
- Pronesia Intelektuale dhe e drejta e autorit.
- E drejta Detare
- Mbledhje borxhi
- Sherbime ndermjetesimi/broker ne fushen tregtare.
- Konsulence biznesi,studime mundshmerie,konsulence per shoqeri tregtare dhe OJF-te, informacion biznesi, mbeshtetje e plote ne procedurat ligjore te rregjistrimit per kompani shqiptare dhe te huaja.

KREU II

KAPITALI



Neni 6

Kapitali themelar

Kapitali themelar fillestar i Shoqerise eshte 100(njeqind) Leke.

Kapitali I Shoqerise eshte I ndare ne 2 kuota:

- a. Zoti Edvin Kepi, zoterues I nje kuote me vlere te pergjithshme 50 (pesedhjete) Leke, qe perben 50 % te kapitalit te Shoqerise;
- b. Zoti Oliget Kume zoterues I nje kuote me vlere te pergjithshme 50(pesedhjete) Leke, qe perben 50% te kaitalit te Shoqerise;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali I Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga Gjykatat kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se Administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët ne te njejtën masë ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 8

Transferimi I Kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejta qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e Shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme nepermjet ortakeve per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

KREU III

ORAGENT VENDIMMARESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Asambleja e Ortakeve

Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimmarres I shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statusit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Cdo kuote garanton te drejten e nje vote ne asamblene e pergjithshme te ortakeve (" Asambleja e Ortakeve"), te drejten per te zgjedhur dhe per tu zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimit te Shoqerise si dhe te drejttat e siguruara nga ky Statut, marreveshjet midis ortakeve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.

Vetem Asambleja e Ortakeve do te kete te drejte te vendose per ceshtjet e meposhtme:

- a. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b. Modifikimin dhe ndryshimin e ketij Statuti;
- c. Te vendose per emerimin dhe shkarkimin e administatoreve te Shoqerise;
- d. Miratimin e rregullave procedutiale te mbledhjeve te asamblese;
- e. Te zmadhoje dhe/ ose te zvogeloje kapitalin e regjistruar;
- f. Vendose er shkrirjen, prishjen, likuidim dhe cdo lloj transformimi tjeter te Shoqerise;
- g. Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- h. Te themeloje/ ose te mbylle dege dhe perfaqesi jashte dhe brenda Shqiperise;
- i. Te miratoje raportet vjetore dhe bilancet dhe te miratoje shperndarjen e fitimit;
- j. Perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administatoreve;
- k. Te vendose mbi pervetesimin, shitjen dhe vendosjen e barres mbi pasurite;
- l. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- m. Te vendose pagen e Administratorit;
- n. Te vendose per percaktimin e eksperteve kontabel te autorizuar;
- o. Te vendose mbi organizimin strukturor dhe administrativ te Shqiperise;
- p. Te vendose mbi buxhetin vjetor;
- q. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- r. Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise te veprimtarise;
- s. Te vendose marrjen e huave apo dhenien e garancive nga Shoqeria;
- t. Te vendose per cdo ceshtje tjeter, qe i takon per zgjidhje asamblese se ortakeve, me ligj dhe/ose sipas ketij statusi.



Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person I trete.

Administratori I shoqerise nuk mund te veproje si erfaqesues I ortakeve ne asamblene e pergjithshme

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblense se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 10

Vendimet e miratuara ne Asamblene e Ortakeve, Kourumi

Ne rastin e vendimeve te miratuara me Shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane prezent ortaket me te drejte vote qe kane me shume se 30% te kuotave te nenshkruara.

Ne rastin kur Asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje te cilat kerkojne Shumice te kualifikuar, Asambleja e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane prezent ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike.

Nese Asambleja e Ortakeve eshte e mbledhur ne menyre korrekte, por numri I kerkuar I ortakeve eshte plotesuar kuorumin nuk eshte prezent apo nuk eshte I perfaqesuar, asambleja e ortakeve do te mblidhet serish por jo me vone se 30 dite. Rendi I dites se asamblense se dyte nuk do te ndryshoje.

Kur Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve nuk eshte thirrur sipas formaliteteve te ligjit ose ketij statuti ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane te pranishem dhe shprehen darkort per te marre vendime, panvaresisht parregullise.

Ortaket kane te drejten qe u njihet nga ligji apo statuti, per te marre unamisht cdo vendim, me kusht qe ai te formalizohet me shkrim.

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Neni 11

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve

Asambleja e Ortakeve do te thirret nga Administratorii Shoqerise nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike te pakten nje here ne vit ne seline e



Shoqerise ose ne cdo vend tjeter te percaktuar ne njoftim brenda gjashte muajve te pare te cdo viti kalendarik per te miratuar asqyrat financiare te Shoqerise te vitit te meparshem financiar.

Asambleja e pergjithshme thirret nga Ambasadori edhe nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim

Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre aktive, te ciat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Me tej anetaret qe perfaqesojne te pakten 50% te votave te pergjithshme te Shoqerise mund ti kerkojne administratorit me shkrim apo me poste elektronike thirrjen e asamblese se ortakeve. Kerkesa duhete te mbaje arsyet dhe objektivat dhe ceshtjet per te cilat asambleja e ortakeve duhet te vendose.

Asambleja e Ortakeve do te thirret me njoftim me shkrim te leshuar nga administratori, I cili duhet tu dergohet perfaqesuesve te ortakeve me leter rekomande ose faks ose poste elektronike(e-mail) jo me vone se 7(shtate) dite perpara dites se caktuar per asamblene.

Njoftimi per ortaket duhet t percaktoje daten, oren dhe vendin e mbledhjes se asamblese si dhe ceshtjet per tu diskutuar (rendi I dites) dhe, ne rast te nje asambleje te zakonshme te ortakeve, duhet te perfshije pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.

Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerise Tregtare.

Neni 12

Administrimi I Shoqerise dhe kompetencat e administratorit

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator I vetem, I emeruar ne perputhje me kete statut.

Administratori I Shoqerise mund te shkarkohet nga pozicioni qe ka ne Shoqeri ne cdo kohe nga Asambleja e Ortakeve me Shumice te Zakonshme. Ne asnje rast ortakeve nuk I duhet te justifikojne apo provojne se cilat shkaqet per te cilat ata shkarkojne administratorin. Ne cdo rast jane ortaket ata te cilet vleresojne se ka shkaqe te arsyeshme per shkarkimin e administratorit.

Administratoti ka te drejte te perfaqesojte Shoqerine ne menyre te plote per administrimin e zakonshem te saj si edhe te drejten per te miratuar te gjitha vendimet qe I gjykon te pershtatshme

per arritur dhe permbushur qellimin e shoqerise, me perjashtim te vendimeve qe me ligj I takojne Asamblese se Ortakeve.

Personi I meposhtem do te caktohet si Administrator I Shoqerise per nje afat 5 vjecar :

Zoti Oliget Petrika Kume lindur me 15.01.1979 ne Elbasan I pajisur me nr. Personal karte identiteti H90115008U

Te drejttat dhe detyrimet e Administratorit jane ato te percaktuara ne ligjin e Shoqerive Tregtare, kete Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe rregullat e brendshme te administrimit te Shoqerise.

Administratori ka te drejttat dhe detyrimet e meposhtme:

- a. Perfaqesimin e Shoqerise kundrejt paleve te treta dhe shtetit;
- b. Hapjen e llogarive bankare te Shoqerise me bankat;
- c. Perfundimin e marreveshjeve me palet e treta, leshimin dhe marrjen e urdher pagesave pas miratimit me shkrim nga ortaket;
- d. Nenshkrimin e te gjithe dokumentave leshimin e faturave, transferimet ne monedhen e huaj, flete ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve te Shoqerise dhe pranimin e letrave me vlere nga palet e treta;
- e. Mbledhjen e detyrimeve qe I takojne shoqerise;
- f. Punesimin dhe shkarkimin e interesave te Shoqerise, percaktimin e pagave shperblimeve dhe pagesave te stafit, pas miratimit me shkrim nga ortaket;
- g. Marrjen e masave paraprake per mbrojtjen e interesave te Shoqerise, ngritjen e padive dhe marrjen persiper te mbrojtjes se Shoqerise ne rast padie kunder saj; administratori mund te udhezaje avokatet te mbrojne Shoqerine dhe mund te percaktoje shumen e shperblimit te tyre ne miratimin paraprak te Asamblese se Ortakeve;
- h. Ambasadori ka te drejte te ngreje padi dhe ti terheqe ate, te nenshkruaje marreveshje gjyqesore, te mbylle marreveshje arbitrazhi, te caktoje arbitra, te terheqe padite e ngritura nga Shoqeria dhe te nderprese procedimet por ne cdo rast perpara kryerjes se ndonje prej veprimeve te mesiperme, administratori duhet te marre miratimin e Asamblese se Ortakeve.
- i. Ndermarrjen e te gjithe veprimeve te tjera qe I takojne aktivitetit te perditshem te Shoqerise nga pikepamja e ligjit dhe ketij Statuti;
- j. Mbajtjen e llogarive ne pperputhje me ligjin dhe parimet e kontabiliteti;
- k. Ppergatitjen e pasqyrave vjetore financiare te Shoqerise dhe kontrollin e tyre nga auditore te jashtem nese kjo kerkohet nga ligji ose nga nje vendim I Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve
- l. Thirrjen e mbledhjeve te Ortakeve; percaktimin e rendit te dites; monitorimin e permbushjes se dispozitave qe kane lidhje me thirrjen dhe drejttimin e mbledhjes se pergjithshme te Ortakeve per shpalljen e vendimeve perkatese;

- m. Te vendose ne dispozicion te Ortakeve te Shoqerise sa here qe te kerkohej prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet ne lidhje me shpenzimet e Shoqerise, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata per te hyrat, deklarata te tjera financiare, fleteparaqitjet tatimore te Shoqerise dhe auditet, nepermjet formes se kerkuar dhe njoftuar nga secili Ortak , si p.sh. nepermjet faxit, postes elektronike apo postes se zakonshme.
- n. Administratori eshte I detyruar te therrase asamblene e pergjithshme te Ortakeve ne rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk I mbulojmne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
 - Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
 - shoqeria brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- o. Krejne rregjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te Shoqerise sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Rregjistrimit;
- p. Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimive, I paraqet keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- q. Cdo detyre tjeter te parashikuar ne ligj.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 13

Viti Financiar dhe Dividenti

Viti financiar I aktivitetit te Shoqerise perkon me vitin kalendarik, fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Pas percaktimit te fitimit te Shoqerise ne perputhje me pasqyrat financiare dhe pas permbushjes se kerkesave te nenit 77 te Ligjit te Shoqerise Tregtare,, fitimi I Shoqerise, deri sa te shlyhet shuma e investimit fillestar, ndahet midis ortakeve sipas perqindjes se tyre ne shoqerise.

Neni 14

Ekspertet



Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara orej tij per rastet kur ai eshte I ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet eriodike te ushtruara, te cilat eshte I detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 15

Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e kompanise mund te behet ne cdo kohe;

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) Me vendim te asamblese se ortakeve
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per qendren kombetare te regjistrimit.
- e) Me vendim te gjykates

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menytrat e likujdimitt te shoqerise, duke caktuar 1 apo me shume likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesën shtese "shoqeri ne likujdim e siper"

Rishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimitt ne gjendjen e aftesise paguese, me erjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person I interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.

Neni 16

Riorganizimi I shoqerise bashkimi-ndarja



Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare.

Neni 17

Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti si dhe per cdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete komponente Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 18

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 2 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e e shoqerise tregtare

THEMELUES DHE ORTAKE TE SHOQERISE

“JUS LEGITIMUM&PARTNERS” SH.P.K

Edvin Kepi



Oliget Kume

